

Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**BARRIERAT E DIALOGUT  
DHE SHKAQET E  
DËSHTIMIT TË TIJ NË  
KOHËN BASHKËKOHORE**



Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**BARRIERAT E DIALOGUT DHE  
SHKAQET E DËSHTIMIT TË TIJ NË  
KOHËN BASHKËKOHORE**

- përvoja e Kosovës me serbët si shembull-

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Dr. Hajredin HOXHA

BARRIERAT E DIALOGUT DHE SHKAQET E  
DËSHTIMIT TË TIJ NË KOHËN  
BASHKËKOHORE

- përvoja e Kosovës me serbët si shembull-

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës. Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

**PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:**

**Sedat ISLAMI**

**Recensent: Ajni Sinani**

**Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani**

**Titulli në origjinal:**

Dr. Hajruddin Huxheh, *Akabatu-l-hivari ve avamilu feshlihi fi-l-asri-l-hadith – et-texhribetu-l-kusufijjetu mea’s-serbi nemudhexhen*, referim shkencor në Seminarin Ndërkombëtar “*El-Hivaru ve ehemmijjetuhu fi-l-fikri-l-islamijj*”, të organizuar nga Fakulteti i Sheriatit dhe Studimeve Islame në Universitetin Sharikah në EBA, 16-18/04/2007.

Dr. Hajredin HOXHA

BARRIERAT E DIALOGUT DHE SHKAQET E  
DËSHTIMIT TË TIJ NË KOHËN  
BASHKËKOHORE

- përvoja e Kosovës me serbët si shembull-

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!**

## **Përmbajtja**

Hyrje

KAPITULLI I: Pozita shoqërore dhe fetare e Gadishullit Ballkanik në kohën moderne

1. Gadishulli Ballkanik si urë lidhëse ndërmjet kulturave dhe civilizimeve në periudhën e sundimit osman
2. Vështrim rreth ngjarjeve politike në Ballkan - karakteristikat e barrierave të dialogut
3. Pasojat negative të qëndrimeve joobjektive të shteteve perëndimore karshi Islamit dhe muslimanëve, si dhe ndikimi i rënies së perandorisë osmane për muslimanët shqiptarë në Ballkan

KAPITULLI II: Komplotet politiko-fetare nga ortodoksët dhe katolikët për shfarosjen e muslimanëve në Ballkan

1. Lëvizja fetare ruso-serbe dhe qëndrimi zhgënjyes evropian karshi çështjes islame në Ballkan si barrierë tjetër dialogu
2. Qëndrimi dëshpërues i shteteve evropiane karshi spastrimit etnik të muslimanëve shqiptarë dhe boshnjakë nga serbët
3. Qëndrimi i njëanshëm i akademisë, politikës dhe fesë në Serbi, si një barrierë e dialogut dhe bashkëjetesës në paqe

Përfundim

Bibliografia



## HYRJE

---

Falënderimet i takojnë Allahut, i Cili në Kur'anin Famëlartë thotë:

*Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.”* (en-Nahl, 125.)

Përshëndetjet qofshin mbi të parin e pejgamberëve, zotërinë tonë, Muhammedin, i cili dialogoi me mosbesimtarët, idhujtarët dhe hipokritët dhe polemizoi me ta duke iu sjellë prova dhe dëshmi sfiduese, deri në Ditën e Kiametit. Përshëndetjet qofshin edhe mbi familjen e tij të pastër dhe shokët e tij besnikë, të cilët sollën shembujt më brilant të mënyrës së bashkëbisedimit dhe dialogut me kundërshtarët dhe mohuesit kryeneçë, dhe këtë me qëllim të kumtimit të shpalljes se Zotit. Allahu qoftë i kënaqur me ta!

Motivi im në përzgjedhjen e këtij hulumtimi ka qenë eksperiencia ime e hidhur me fqinjët tanë të “ndershëm”, me të cilët patëm jetuar një kohë të gjatë, e që në fakt nuk e prisja kurrë të ndodhte ajo që ndodhi. Kështu, me këtë punim mëtoj të vetëdijesoj njerëzit, pa marrë parasysh racën, gjuhën apo fenë e tyre, karshi këtij lloji fqinjësh “të ndershëm.”

Konsideroj se bisedat dhe shkrimet rreth përvojës së dialogut të dështuar ndërmjet muslimanëve shqiptarë të Kosovës dhe fqinjëve të tyre serbë ortodoksë, pastaj bisedat për përvojën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare të pretenduar ndërmjet tyre, si dhe shqyrtimi i shkaqeve dhe motiveve të atyre masakrave të përgjakshme të serbëve ndaj shqiptarëve muslimanë, kanë një rëndësi të madhe në historinë e dialogut ndërkulturor, ndërpopullor dhe ndërfitetar në kohën moderne.

Dështimit të këtij dialogu dhe kësaj bashkëjetese i faturohet një mori shkaqesh, si:

- Qëndrimi negativ i orientalistëve serbë, të cilët nuk ndaleshin nga shpifjet dhe shkrimet e tyre përplot helm kundër muslimanëve kosovarë dhe boshnjakë, të cilat në fakt ishin si një parapërgatitje për

pushtimin dhe invadimin serb në Bosnjë dhe Kosovë. Edhe priftërinjtë e kishës ortodokse kanë luajtur një rol të madh në nxitjen e këtyre luftërave dhe kasaphanave të përgjakshme duke ndjellë vrer dhe urrejtje në emër të luftës së shenjtë ndërmjet kryqit dhe hënës, Inxhilit dhe Kur'anit. Në fakt, thirrjet e tyre ishin për të shpëtuar ortodoksët nga pushtimi osman. E hiç më mirë nuk qëndronin as politikanët nacionalistë dhe fanatikë, të cilët - thënë të vërtetën - qenë vetëm implementues të ideve të mendimtarëve dhe figurave serbe (prej tyre orientalistë të shumtë) dhe figurave fetare, të cilët i nxitën të nxjerrin vendime dhe urdhra ushtarakë për vrasje, mbytje, shfarosje dhe shkatërrim të muslimanëve dhe tokave të tyre, për të ushqyer kështu ambiciet e tyre personale dhe qëllimet e tyre politike.

Boshnjakët dhe muslimanët kosovarë përjetuan periudhën më tragjike dhe më të vështirë shoqërore, fetare dhe njerëzore qysh prej Luftës së Dytë Botërore. U vranë njerëz të pafajshëm, burra, gra, fëmijë, pleq; viktima nuk zgjidhej, me rëndësi ishte të vritej. Tërë ky tmerr u mundësua nga forcat kriminele dhe grupet serbe (të ashtuquajtura) të vdekjes, që ishin të armatosura deri në dhëmbë dhe që ishin nën komandën e sistemit socialist komunist serb.

Këto masakra sigurisht se nuk do të kryheshin nga fqinjët tanë "të ndershëm" sikur ata të mos i respektonin verbërisht ata mendjelehtit, fanatikët, ekstremistët dhe nacionalistët e tyre politikë, ideorë dhe fetarë. Ky trekëndësh i hekurt apo këto tri grupe qëndrojnë pas shfarosjes kolektive dhe spastrimit etnik të muslimanëve boshnjakë dhe kosovarë. E sa shumë i përshtatet presidentit të tyre thënia e Allahut për Faraonin e mallkuar dhe popullin e tij:

*O populli im, sot pushteti është juaji në vend, po kush do të na mbrojë prej dënimit të All-llahut nëse ai na përfshin? " Faraoni tha: "Unë nuk kam mendim tjetër t'ju jap pos atij që ju thashë dhe nuk jam duke u udhëzuar tjetër pos në rrugën e drejtë!" (Gafir, 29)*

Me këtë stil diktatorial presidenti serb, tashmë i vdekur, Slllobodan Milloshevic iu drejtua popullit dhe parisë së tij nga toka e Kosovës<sup>1</sup>.

Shembujt e këtij krimineli konsiderohen si pengesa kyçe për suksesin e dialogut dhe rolit të tij në jetën tonë private dhe kolektive. Nuk kemi zgjidhje tjetër vetëm se këto figura ekstreme, qofshin nga jeta politike, ideore apo fetare, t'i izolojmë dhe në vend të tyre të hulumtojmë për personalitete, të cilat, së paku të udhëhequra nga fryma njerëzore, do të projektojnë një ardhmëri për një bashkëjetesë të ndershme, nën hijen e paqes, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë, pa marrë parasysh besimin e tyre.

Fokusimi ynë në këtë punim do të jetë në ajetet kur'anore, hadithet pejgamberike, të dhënat e sakta historike të shqiptarëve dhe Evropës, në të kaluarën dhe tanishmen, dhe tërë këtë me qëllim që të zbulojmë defektet politike, fetare dhe ideore që kanë shkaktuar këto barriera.

Pyetjet, të cilave mundohet t'iu përgjigjet ky referim shkencor në këtë seminar, janë si vijojnë:

1. Për çfarë shembulli merrej Gadishulli Ballkanik, në lidhje me bashkëjetesën ndërmjet kulturave dhe civilizimeve të ndryshme, në kohën e shtetit osman?
2. Cili është roli i shteteve të krishtera, katolike e ortodokse, në Evropën lindore në ndezjen e këtyre luftërave fetare dhe pengimin e dialogut ndërmjet muslimanëve shqiptarë dhe serbëve ortodoksë?
3. Cili është roli famëkeq i politikanëve, mendimtarëve dhe liderëve fetarë serbë në shkatërrimin e dialogut dhe bashkëjetesës së paqme ndërmjet shqiptarëve muslimanë dhe serbëve ortodoksë?

E lus Allahun të më ndihmojë dhe të më bekojë për të drejtën dhe të saktën përkitazi me këtë referim, në këtë seminar të organizuar nga Universiteti esh-Sharikah!

Përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin!

Falënderimet qofshin vetëm për Allahun, Zotin e botëve!

---

<sup>1</sup> Varfi, Safvet, *Me'satu muslimi Kusufa ve vaxhibuna nahvehum*, (Mexhel-letu'l bejan, islamijetun shehrijetun, v.138, qershor 1999), f. 72.

# KAPITULLI I: POZITA SHOQËRORE DHE FETARE E GADISHULLIT BALLKANIK NË KOHËN MODERNE

---

## 1. GADISHULLI BALLKANIK SI URË LIDHËSE NDËRMJET KULTURAVE DHE CIVILIZIMEVE NË PERIUDHËN E SUNDIMIT OSMAN

Konfliktet dhe luftërat që përjetoi Gadishulli Ballkanik, në përgjithësi, dhe tokat boshnjake dhe ato shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni, në veçanti, ngjallën interesimin e hulumtuesve muslimanë dhe jomuslimanë nga Perëndimi dhe Lindja. Muhammed Mufak Arnauti<sup>2</sup> thotë: Duket se interesimi arab për Gadishullin Ballkanik ka filluar të rritet vetëm në dekadën e fundit të shek. XX-të, respektivisht nga luftërat dhe fatkeqësitë që goditën ish-republikat jugosllave<sup>3</sup> në periudhën 1991-1999.

Kështu, nëpërmjet transmetimit në media, sidomos në TV dhe kanalet satelitore, të atyre pamjeve trishtuese të luftërave në Ballkan, interesimi i arabëve për këto vise u shtua dhe kështu u zbuluan popuj dhe kultura të

---

<sup>2</sup> Muhammed Mufak Arnauti është me origjinë shqiptare. Ka lindur në Damask, në një familje të shpërngulur nga Kosova. Studimet i kreu në Universitetin e Damaskut, në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Arabe. Kreu magjistraturën në histori, ndërsa doktoratën e mbaroi në Universitetin e Prishtinës, në letërsinë krahasimtare. Një kohë ka punuar në Departamentin e Orientalistikës në UP. Është autor i shumë studimeve dhe hulumtimeve përkitazi me çështje arabe jugosllave, si: *Muhtarat min'esh-shi'ri'-l- albanijji-l-muasir* (Përzgjedhje nga poezitë bashkëkohore shqipe); *Dirasat el-Islam fi'-l-balkan* (Studimet islame në Ballkan). Aktualisht punon në Institutin Bejtü'l hikmeh në Universitetin Al el-Bejt, në Amman, Jordani. Disa prej punimeve më të rëndësishme të tij: *Eth-thekafetu-l-albanijjetu fi'-l-ebxhedijjeti-l-arabijjeh* (Kultura shqiptare në abecënë arabe), Kuvajt, 1983; *Tarihu Belgrad el-Islamijjeh* (Historia islame e Beogradit), Kuvajt, 1987; *Melamih arabijjeh islamijjeh fi'-l-edebi-l-albanijj* (Tipare arabo-islame në letërsinë shqipe), Damask, 1990; *El-Islami fi Juguslafija min Belgrad ila Sarajefu* (Islami në Jugosllavi, nga Beogradi e deri ne Sarajevë), Amman, 1993; *Dirasat fi'-t-tarihi-l-hadarij lil-Islam fi'-l-Balkan* (Studime në historinë kulturore të Islamit në Ballkan), Tunis - Dubai, 1996; *Kusufu - Kusufa bu'retu=n-nizai-l-albanijji-s-serbijj fi'-l-karni-l-ishrine* (Kosovo - Kosova fokus i konfliktit shqiptaro-serb në shek. XX), Kajro, 1998.

<sup>3</sup> Ismajtsh, Abdullah, *Es-Sirau fi Juguslafija ve mustakbelu-l-muslimine*, Ma'hed ed-dirasat es-sijasijjeh, përktheu: Saib Alavi, (Islamabad, ed.1), f. 10-60.

këtyre viseve që nuk kishin qenë shumë të njohura për ta. Si shembull, për ilustrim, do të doja të përmendja faktin se, vetëm gjatë viteve të 90-ta, për Bosnjën u shkruan hiç më pak se 30 vepra, ndërsa në 30 vitet e kaluara (para viteve të 90-ta) nuk qe botuar as edhe një libër i vetëm<sup>4</sup>. E për rëndësinë që kanë këto lloj punimesh dhe studimesh për bibliotekën dhe lexuesin arab, Arnauti shton: *“E bazuar në këtë, shihet se ka ardhur koha e themelimit të një reference të re njohurish në gjuhën arabe, përkitazi me shtetet dhe popujt e Ballkanit si dhe me raportet e tyre me regjionet përreth, me theks të veçantë me regjionin arab, që nuk mund të thuhet se është tërësisht i ri (panjohur) për këtë regjion....Raportet ndërmjet tyre kanë shënuar një pikë kthese të re gjatë shekujve të VI-të dhe VII-të, atëherë kur Islami u shfaq dhe u përhap në Gadishullin Arabik dhe në shtetet e Shamit, Irak, Egjipt, Afrikë Veriore (në njërin anë) dhe ardhja dhe përhapja e sllavëve në Gadishullin Ballkanik, ku faktikisht edhe u bënë shumicë e atyre popujve (në anën tjetër).”*<sup>5</sup>

Ndërsa për fillimin e lidhjeve sllave ballkanase me arabët, para periudhës osmane dhe gjatë saj, Arnauti shton: Këto marrëdhënie në fillim ishin të shprehura në luftëra dhe beteja, ndërmjet bizantinëve dhe muslimanëve, e më pastaj morën formë në kuadër të subjekteve të reja (të krijuara nga shpërbërja) në Ballkan (Bullgaria, Serbia, etj) dhe në rajonin arab (Shteti i Fatimijëve, Shteti i Memlukëve etj.), për t’u zgjeruar më vonë kur të dy palët do të hynin në kuadër të një kornize të vetme, atë të Shtetit Osman. Nuk ka dyshim se bashkëjetesa e gjatë, përmbi 400 vite, paraqet shtrirjen më të gjatë dhe më të pasur ndërmjet dy palëve. Rol të madh gjithsesi në këtë drejtim ka luajtur edhe faktori fetar, i cili tek disa popuj u bë fe e shumicës, siç ishte rasti me shqiptarët dhe boshnjakët, apo fe e pakicave, sikur ishte rasti në Bullgari, Serbi, Kroaci dhe Greqi. Kështu, të gjendur në këtë situatë, ku afërsisht gjysma e banorëve të Ballkanit ishin muslimanë dhe ku mbi 100 qytete morën një sfond lindor (islam), nuk kishte si të mos shtrihej ndikimi lindor, aq sa veriu i Ballkanit, apo më saktësisht, Beogradi, quhej ‘Porta e lindjes.’ Kjo ngase evropianët me të hyrë në Beograd krijonin përshtypjen se kaluan kufirin ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes<sup>6</sup>.

Ndërsa përkitazi me folklorin, kulturën popullore ballkanase dhe specifikat e saj, Profesor Mufaku shton: Folklori i tyre, e në veçanti ai bullgar, jugosllav dhe shqiptar, shquhet për praninë e elementeve arabe,

---

<sup>4</sup> Arnauti, Muhammed Mufak, *Mudahalat arabijeh – balkanijeh fi't-tarihi-l-vesit ve-l-hadith*, Ittihadu-l-kitabi-l-arab, ed.1, 2000, Damask, f. 5.

<sup>5</sup> Ibid, f. 6.

<sup>6</sup> Ibid, f. 6.

gjë që ka për pasojë edhe diskutimet e shumta rreth natyrës mitologjiko-historike të kësaj pranie. Studiues dhe orientalistë të shumtë kanë trajtuar në punimet e tyre këtë tematikë, si:

- Rade Bogovic, në tezën e doktoratës, '*Arabi në këngët gojore të popullit në gjuhën serbokroate*',
- Egjiptiani Dr. Xhemaluddin Sejjid Muhammed, po kështu në një tezë doktrate me titull '*Arabët dhe frazat arabe në novelat në gjuhën serbokroate*',
- Autori i këtij punimi, në një pjesë të doktoratës, ku trajtoi '*Lidhjet letrare shqipo-arabe...*'

Toleranca e shtetit osman me vendet e Ballkanit është një fakt që dëshmohet nga shumica absolute<sup>7</sup>. Pavarësisht etnisë dhe përkatësisë fetare, të gjithë kanë jetuar së bashku në paqe dhe siguri: shqiptarët, serbët, boshnjakët, bullgarët, turqit, kurdët, arabët, armenët, sllavët, muslimanët, të krishterët, çifutët, fraksionet e ndryshme nga të gjitha fetë. Historia nuk ka shënuar ndonjë incident fetar gjatë kohës së sundimit osman<sup>8</sup>. Shteti pati përvetësuar një sistem qeverisës ku nuk shkeleshin të drejtat. Ishte sistemi i quajtur '*Nidham el-mil-leh*<sup>9</sup>', i cili i nxirrte dispozitat duke u mbështetur në të drejtat e *dhimmiyëve* (jomuslimanëve që jetonin në shtetin islam) dhe që nuk mbështetej në ide nacionaliste turko-turane<sup>10</sup>. Ndoshta

---

<sup>7</sup> Mbreti i Francës ia kishte vënë Sulltan Sulejman Kanuniut, për hir të tolerancës së tij, epitelin '*Mbrojtësi i katolikëve në trojet islame*.' Shih: Beni el-Merxheh, Muveffak. (1999) *Sahvetu-rr-rrexhuli-l-merid - es-Sultan Abdul Hamid II ve-l-hilafetu-l-islamijeh*. Bejrut: Muessesetu-rr-rrejjan - Daru-l-bejarak. Ndërsa për njohuri më të shumta rreth temës në fjalë shih: Salabi, Ali Muhammed. (2001) *Ed-Devletu el-uthmanijjetu - avamil en-nuhud ve esbab es-sukut*. Kajro...; Beg Halim, Ibrahim. *Tarihu-d-devleti-l-uthmanijjeti-l-alijeh*. Bejrut: Muessesetul kutub eth-thekafijeh; Harb, Muhammed. (1999) *El-Uthmanijjune fi-t-tarih ve-l-hadareh*. Damask: Darul kalem. Ajo që ia vlen të theksohet këtu është se autori përmend tolerancën si një prej shkaqeve të rënies së perandorisë osmane, kuptohet për shkak të keqpërdorimit (tradhtisë) së të krishterëve dhe kompleteve të tyre ndaj shtetit islam.

<sup>8</sup> Ibid.

<sup>9</sup> Për përpjekjet e misionarëve të krishterë dhe orientalistëve për shkatërrimin e këtij *nidhami*, shih referencën paraprake, f. 165-176.

<sup>10</sup> Harb, Muhammed. *Sulltan Abdul Hamid II - ahiru-s-selatin el-uthmanijjine el-kibar*. F. 110-111.

kjo dëshmi historike njafton për këtë të vërtetë. Në lidhje me këtë, prof. dr. Muhammed Arnauti shton: Për herë të parë, historiani Muxhiruddin Hanbeliu, në vitin 1496, në librin e tij *'El-Unsu-l-xhelil bi-tarihi-l-Kudsi ve-l-Halil'*, në kuadër të portave të Kudsit, përmend portën e serbëve 'Bab dijeri-s-serb', gjë të cilën shekuj më vonë, respektivisht në vitin 1701, e përmend edhe Shejh Abdul Gani Nabulsi në veprën e tij *'El-hadretul-unsijeh bi-rr-rrihleti-l-kudsijeh.'* Ajo që na intereson neve është se bëhet fjalë për shtëpi dhe vakëfe serbe gjatë shekullit të parë të sundimit otoman (1516-1616)<sup>11</sup>.

Kësisoj, bazuar në rëndësinë që ka ruajtja e raporteve kulturore në jetën tonë publike dhe private, Islami na ka urdhëruar që të bashkëbisedojmë, ta kuptojmë njëri-tjetrin, të njihemi ndërmjet vete dhe të ndihmohemi në të mbara, pavarësisht dallimeve që kemi. Jemi urdhëruar të mbajmë lidhje njerëzore dhe t'i thërrasim në fenë tonë me dialog, diskutime, polemika, etj. Analistët, duke pasur parasysh rëndësinë e dialogut për jetën shoqërore dhe politike, kanë thënë se (dialogu) *'me të gjitha format, emërtimet, termat, bëhet një prej gjërave të domosdoshme të jetës dhe garantuese e vazhdimit të saj (në tokë)..'*<sup>12</sup> Nëse janë mjeshtër të prezantimit, dialogut, argumentimit dhe sqarimit, atëherë me këtë do të lehtësohej në mënyrë të dukshme zgjidhja e problemeve dhe, praktikisht, do të ishim një hap para...<sup>13</sup>

Disa të tjerë e kanë konceptuar këtë përafrim si *'marrëveshje për modusin më të madh të përbashkët, tek i cili edhe takohen.'*; *'nisje nga pikat ku pajtohem, jo nga ato ku kemi kundërthënie, nisje nga objektivat, jo nga mjetet.'* Por, Dr. AbduRrezzak el-Mukri sqaron se pajtim të plotë nuk ka, nuk mundet (të ndodhë realisht)<sup>14</sup>.

---

<sup>11</sup> Arnauti, Muhammed. *Mudahalat arabijeh balkanijeh*. F. 19-38.

<sup>12</sup> . Shih: *El-Hivar, edh-dhat, el-ahar* të Dr. Abdu-s-Settar Ibrahim Hitit, libër i nxjerrë në kuadër të serisë Kitabul Ummeh nga Ministria e Fesë në Shtetin e Katarit.

<sup>13</sup> Ibid. Shih edhe: Selman Aude, *Edebu-l-hivar*, ku autori përmend tri rregulla të rëndësishme sa i përket dialogut: 1. Përcaktimin e temës së dialogut 2. Diskutimin për çështjet kyçe, jo ato sekondare, 3. Pajtimin për një bazë, të cilës i referohet (dialogut). Për më shumë shih: [www.islamtoday.net](http://www.islamtoday.net)

<sup>14</sup> Ibid.

Për të realizuar në praktikë frytet e një bashkëpunimi të tillë, ka njerëz që besojnë se duhet funksionalizuar roli i dijetarëve dhe hulumtuesve në udhëheqjen e shtetit, rolin e OJQ-ve dhe instituteve kulturore e shkencore, (duhet funksionalizuar çështja e) të diskutuarit për interesat e përgjithshme si temë në vete dhe se dialogu, nëse ndërtohet mbi respektin reciprok, diskutimin dhe frymën shkencore, pa pasuar epshin apo pa shfaqur fanatizëm, atëherë kjo, me lejen e Allahut, do të ketë efekte pozitive<sup>15</sup>. Ndryshe, fanatizmat, grupimet, imitimet e verbra, denigrimi, partizimi janë gjëra që e detyrojnë ummetin ta rishikojë veten, të planifikojë strategji dhe programe për t'u rikthyer tek vetja, për të dialoguar me veten, për të shtrirë urat ndërmjet rrënjëve dhe ëndrrave të tij të shpërndara (realizimin e të cilave e dëshiron).

Këtu ka dhe një çështje tjetër, konsideroj shumë të rëndësishme, të cilën duam ta shtjellojmë. Fjala është për të startuar në dialogun tonë me *tjetrin* nga njohuritë tona për të, për elementet që përbëjnë kulturën e tij, dhe jo nga ajo që ne duam dhe shpresojmë të jetë ai. Dialogu me tjetrin nuk mund të paramendohet përderisa ne nuk e kemi pranuar atë, ndërsa kjo, pra pranimi se ai ekziston dhe se ka bindjet dhe idetë e tij, nuk nënkupton se ne i miratojmë dhe pajtohemi me to.

Kushdo që shfleton historinë peygamberike do të gjejë shembuj të shumtë dhe të shkëlqyer të dialogut të peygamberit Muhammed [*alejhis salatu ves selam*] me armiqtë e tij. Madje, nëpërmjet negociatave dhe diskutimeve, janë arritur edhe një sërë marrëveshjesh, kartash dhe pikash të përbashkëta të rëndësishme. Karta e Medinës, në lidhje me banorët e saj, ndër të cilët kishte dhe çifutë, 'Marrëveshja e Hudejbijes' me idhujtarët<sup>16</sup> dhe shumë të tjera, nuk janë tjetër veçse dëshmi për pranimin e këtij realiteti, i cili nuk ka

---

<sup>15</sup> Këtë gjë e diskutuan edhe liderët e gjashtë vendeve të Evropës Juglindore (Bosnja, Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Bullgaria) në një Samit të përbashkët të organizuar në Tiranë nga UNESCO. Pjesëmarrës, përveç liderëve ishin edhe më shumë se njëqind diplomatë të huaj, gazetarë dhe analistë. Që të gjithë u dakorduan për nevojën e dialogut, si çelës i vetëm i përmirësimit të raporteve ndërmjet popujve ballkanikë. Shih: [www.albnet.gr/alba/11dhjetor.htm](http://www.albnet.gr/alba/11dhjetor.htm)

<sup>16</sup> Dr. Mustafa As-Sibaa'ie, *The life of prophet Muhammad – Highlights and Lessons*, International Publishing House, 1<sup>st</sup> edition, 2004, Riyadh, Saudi Arabia, 68-70.



ngelur në formalitet porse është jetësuar edhe në praktikë, në kuptimin e dialogut të përbashkët<sup>17</sup>. Por, këto ura nuk do të shtrihen kuturu, ashtu siç kanë bërë disa muslimanë në disa vende arabe, në Magrib (Marok) p.sh., ku kanë bashkëpunuar me koret muzikore të misioneve të krishtera amerikane, me pretekstin se muzika është gjuha e dialogut për të gjitha fraksionet fetare, pa përjashtim<sup>18</sup>.

Sa shumë i përshtatet mentalitetit serbo-ortodoks thënia: *“Ithtarët e vizioneve të mbyllura, trashëgimia dhe vlerat e të cilëve nuk posedojnë edhe hapësirën për diversitet, janë të paaftë kulturalisht për të organizuar dialog, edhe nëse pretendojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo, ngase ata mendojnë se konflikti është mënyra e vetme e heqjes qafe të tjetrit, zbutjes dhe nënshtrimit ndaj zotërisë së pushtetshëm.”*<sup>19</sup> Ata qenë mashtruar nga ballafaqimi me boshnjakët dhe shqiptarët duke menduar se filozofia e tyre së shpejti do t’i jepte frytet, por harruan se pas këtij ballafaqimi fshiheshin pasoja të rënda, ndërsa *‘mësimi merret nga përfundimet (rezultatet).’*

---

<sup>17</sup> Ibid. Shih edhe: A building Bridges between Islam and the West, The Wilton Park Seminar, Wilton Park, West Sussex, december 13, 1996. [www.bbcworld.com](http://www.bbcworld.com). Po kështu shih edhe këtë artikull të rëndësishëm: Building bridges between christianity and ther religions. [www.intervarsity.or/ism/article/105](http://www.intervarsity.or/ism/article/105)

<sup>18</sup> Shih: Building a brige between faiths in highly muslim kation, [www.cbn.com](http://www.cbn.com)

<sup>19</sup> Kjo është ajo që bënë serbët me shqiptarët muslimanë në shek. e XX-të. Këtë qëndrim dëshpërues të Evropës karshi muslimanëve ballkanas, dhe në veçanti karshi atyre shqiptarë, do të mundohemi ta vërtetojmë në pjesë tjera të këtij punimi. Shih: *El-Hivar, edh-dhat, el-ahar* të Dr. Abdu-s-Settar Ibrahim Hitit, libër i nxjerrë në kuadër të serisë Kitabul Ummeh nga Ministria e Fesë në Shtetin e Katarit.

## 2. VËSHTRIM RRETH NGJARJEVE POLITIKE NË BALLKAN – KARAKTERISTIKAT E BARRIERAVE TË DIALOGUT

Nëpërmjet një vështrimi historik rreth zhvillimit të ngjarjeve politike, fetare dhe shoqërore në Ballkan, do të mundohemi të hedhim dritë mbi shkaqet e brendshme dhe të jashtme, të cilat ndikuan në njëërën apo tjetrën mënyrë në dështimin e dialogut ndërmjet popujve ballkanikë. Rikthimi në histori, për rastin tonë, është shumë i rëndësishëm, ngase ndryshe nuk do të arrijmë dot deri tek evidentimi i pikave të dobëta që kanë shkaktuar përçarjet ndërmjet këtyre popujve. Në mënyrë që e kaluara të mos përsëritet edhe në të tanishmen, patëm dëshirë të bëjmë një përmbledhje të shkurtër të saj.

Burime të rëndësishme shqiptare dhe evropiane flasin për një çështje tejet të ndjeshme, atë të ashtuquajturës “Krizë e Evropës Lindore” (1875-1878), e cila ka të bëjë me ngjarjet ballkanike dhe aspiratat e shteteve evropiane dhe planet e tyre për ndarjen e tokave ballanike. Po kështu flitet edhe për negociatat e larta diplomatike me turqit dhe përpjekjet e vazhdueshme për rrëzimin e perandorisë osmane. Ne u ndalën në zhvillimin e ngjarjeve në Ballkan në fund të shekullit të XIX-të dhe në fillim të atij të XX-të, dhe nëpërmjet studimit arritëm të evidentojmë disa nga shkaqet kryesore që çuan në ndezjen e konfliktit ndërmjet popujve muslimanë dhe atyre sllavo-ortodoksë. Me këtë do të doja të citoja historianin e madh musliman, Ali Muhammed Salabin, i cili duke përshkruar problemin në fjalë thotë: “Malazetët dhe serbët i nxisnin boshnjakët për t’u çuar kundër shtetit osman, përpjekje këto që në vitin 1876 shkuan huq. Sulltani Abdul Hamidi II orvatej të pengonte ndërhyrjen e shteteve evropiane, kështu që nxori një dekret me të cilin e ndante gjykatën nga ekzekutivi, duke caktuar që gjykatësit të zgjidheshin me votim nga familjet. Po kështu, barazoi në taksa muslimanët dhe jomuslimanët, por as kjo nuk i kënaqi banorët. U organizuar kryengritje, por ato u shuan shpejt. Por, Austria, e cila qëndronte prapa këtyre revolucioneve të dështuara, për shkak të

ambicieve për të marrë Bosnjën nën pushtet, kërkoi nga Sulltani reformim, kërkesë kjo e mbështetur edhe nga Rusia, Gjermania, Franca dhe Anglia, dhe të cilën Sulltani e kishte pranuar, por jo dhe të krishterët. Këta të fundit e refuzuan një gjë të tillë dhe në kryengritje u çuan edhe bullgarët. Edhe këta patën mbështetjen e Austrisë dhe Rusisë, e veçanërisht kësaj të fundit, e cila themeloi shoqata ruse në Bullgari për të përhapur ndikimin e saj tek banorët ortodoksë dhe sllavë, të cilët në fakt i furnizonte me armatim. Këta banorë i nxisnin serbët dhe boshnjakët për kryengritje kundër osmanëve në kohën kur vendet evropiane përhapnin dezinformata për kinse masakra të osmanëve ndaj të krishterëve, ndërsa në fakt ishte e vërtetë e kundërta. Rusia, Gjermania dhe Austria i nxisnin serbët dhe malazezët kundër osmanëve, për shkak të ambicieve të tyre për të përfituar territor. Rusia dëshironte të zgjerohej nga ana e Bullgarisë, ndërsa Austria nga Bosnja. Këto shtete nuk ndaleshin së premtuari ndihmë dhe përkrahje për princin serb, në rast se ngrihej kundër turqve. Rusët filluan të vërshonin në qytetet serbe dhe malazeze por shteti osman i mposhti ata dhe aleatët e tyre. Shtetet evropiane intervenuan për kinse ta ndaluar luftën, ndryshe do të ndizej luftë e madhe. Përfaqësuesit e vendeve evropiane u mblodhën në Stamboll dhe i prezantuan Portës së Lartë propozimet e tyre, ndër të cilat si më të rëndësishme ishin:

- 1) Ndarja e Bullgarisë në dy vilajete, të sunduara nga të krishterë,
- 2) Emërimi i një komisioni shtetëror për ekzekutimin e vendimeve,
- 3) Këto specifika të vlejné edhe për Bosnjë Hercegovinën
- 4) Perandoria të heqë dorë nga disa toka në dobi të serbëve dhe malazezëve..."<sup>20</sup>

Ndërsa për rolin dekonstruktiv të klerikëve ruso-ortodoksë në dialogun ndërshtetëror, Salabi thotë: Rusia, për shkaqe fetare, ekonomike dhe gjeografike, mëtonte arritjen (depërtimin) deri tek ujërat e qeta. Piter Alekseviqi i Madh (1627-1725), në testamentin e lënë, i porosiste rusët për

---

<sup>20</sup> Salabi, Ali Muhammed. *Ed-Deoletu el-uthmanijjetu – avamilu-n-nuhud ve esbabu-s-sukut*, f. 408-410.

konflikt kulturor kundër osmanëve derisa shteti i këtyre të fundit të merrte fund. Në paragrafin e nëntë thotë: Le t'i afrohem Kostandinopojës dhe Indisë sa të kemi mundësi, për arsye se kush e ka Kostandinopojën, e ka në dorë tërë botën. Kësisoj, lufta me osmanët duhet të vazhdojë...Le të bashkëpunojmë me Austrinë për deportimin e turqve nga Evropa, e kur ta kemi bërë, atëherë le t'i bashkojmë ushtritë dhe flotat tona në Baltik dhe Detin e Zi dhe të fillojmë negociatat me Francën dhe Austrinë për ndarjen e botës në mes nesh.<sup>21</sup>

Porositë e Piterit nuk ranë në "veshë të shurdhër." Rusët i kushtuan rëndësi dhe filluan kurthet e tyre duke i mbështetur, bashkërisht me vendet e tjera evropiane, kryengritjet që organizoheshin kundër osmanëve. Madje Rusia u angazhua edhe në krijimin e shteteve të reja të krishtera, si Rumania, Bullgaria, Serbia, Greqia, gjë të cilën e dëshmon edhe marrëveshja e Shën Stefanit me osmanët, e cila mban datën 15 shkurt 1878 dhe e cila, ndër të tjera përmban këto pika:

- 1) Përcaktimi i kufijve për Malin e Zi, për të shmangur konfliktin, dhe pavarësimin e tij
- 2) Principata serbe pavarësohet dhe përfiton edhe toka të reja
- 3) Bullgaria pavarësohet individualisht dhe (edhe) në mënyrë administrative, që nënkupton se nëpunësit e saj janë të krishterë
- 4) Rumania pavarësohet plotësisht
- 5) Porta e Lartë merr përsipër ruajtjen e armenëve dhe të krishterëve nga kurdët dhe çerkezët
- 6) Shteti osman paguan gjobën luftarake në një vlerë prej 250 milionë lirash ari<sup>22</sup>.

Për këtë dëshmojnë dhe rekomandimet dhe vendimet e dala nga Kongresi i Berlinit në vitin 1887, në të cilin u votua edhe ndërrimi i disa neneve të

---

<sup>21</sup> Ibid. Shih edhe: Harb, Muhammed. *El-Uthmanijjune fi-t-tarih ve-l-hadareh*, f. 128-147.

<sup>22</sup> Ibid, f. 412-413.

marrëveshjes së mëparshme (Shën Stefanit), për shkak të mos përmbushjes së disa interesave të vendeve evropiane.

Një gjë mbetet sa e çuditshme aq edhe konfuze. Përse, në të dy marrëveshjet, faktori musliman në Ballkan nuk është përmendur fare, as nga rusët dhe as nga osmanët, kur dihet se formimi i shteteve të vogla ortodokse të krishtera, e që ishin fqinj të tyre, si Serbia, Mali i Zi, Greqia, Bullgaria, paraqisnin rrezik potencial për ekzistencën e shqiptarit musliman?...<sup>23</sup>

Ky ilustrim historik është një nga ato faktet dëshpëruese që mjaftojnë për të pasqyruar qëndrimin e njëanshëm dhe aspak objektiv e human të shteteve evropiane karshi popujve islamë në Ballkan, e me theks të veçantë shqiptarëve dhe boshnjakëve. Këto qëndrime turpëruese mbase janë pengesë në kohën tonë, bile ndër pengesat kryesore, pse dështon bashkëjetesa paqësore ndërmjet këtyre popujve<sup>24</sup>.

---

<sup>23</sup> Feraj, Hysamedin. *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 38.

<sup>24</sup> Për më shumë rreth historisë austrohunareze në Bosnjë dhe Hercegovinë shih: Karçiç, Fikret. *The Bosniaks and the challenges of modernity, late Ottoman and Hapsburg times*, 120-125; *Journal of Islamic Studies*, Vol.5, No.2, July 1994, Oxford University Press; Lopasiç, Alexander. *Islamization of the Balkans with special reference to Bosnia*, 163-186.

### 3. PASOJAT NEGATIVE TË QËNDRIMEVE JOOBJEKTIVE TË SHTETEVE PERËNDIMORE KARSHI ISLAMIT DHE MUSLIMANËVE, SI DHE NDIKIMI I RËNIES SË PERANDORISË OSMANE PËR MUSLIMANËT SHQIPTARË NË BALLKAN

Historia dhe çështja e muslimanëve shqiptarë është e lidhur ngushtë me fatin e Perandorisë Osmane. Është vërtetuar historikisht se shumë shqiptarë kanë qenë në funksione të larta shtetërore në administratën e Shtetit Osman<sup>25</sup>. Prej tyre ka pasur të atillë që kanë qenë në pozitën e ministrit apo madje edhe të kryeministrit, e po ashtu ka pasur edhe liderë fetarë. Këto figura politike dhe fetare kishin një ofiq dhe thirreshin 'Sadri Azem<sup>26</sup>', 'Shejhul islam.' Janë diku rreth dyzet personalitete të larta shqiptare që i kanë ushtruar këto pozita në administratën osmane. Kështu, çfarëdo zhvillimi që mund të ketë ndodhur në Perandori dhe i çfarëdo fushe që të ketë qenë ai, gjithsesi se ka reflektuar edhe tek shqiptarët, si për të mirë, ashtu edhe për të keq.

Kjo epokë ka dhe një tjetër karakteristikë. Ajo shquhet për kryengritjen e disa liderëve shpirtërorë nga radhët e shqiptarëve. Ishin këto ditët e dobësimit të Perandorisë dhe dobësimi i saj nënkuptonte edhe dobësimin e shqiptarëve. Në këtë kohë, shtetet fqinje të krishtera, me mbështetjen edhe të vendeve evropiane, nxitonin për t'u pavarësuar nga perandoria dhe paraqisnin rrezik për shqiptarët pasi që donin zgjerimin e shteteve të tyre në llogari të tokave shqiptare<sup>27</sup>. Mund të themi se deri diku ia kanë arritur

---

<sup>25</sup> Alpan, P. Nexhip-Kaci, Nesim. *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, f. 22-23.

<sup>26</sup> 'Sadri Azem' ka qenë një post i ngjashëm me postin e Kryeministrit të sotëm. Për më shumë shih: Saban. Suhejl. *El-Mu'xhem el-meusijj lil mustalaht el-uthmanijeh et-tarihijeh*. F. 143-144.

<sup>27</sup> Për padrejtësitë dhe gabimet e Perëndimit ndaj shqiptarëve muslimanë, shih këtë punim të vyer: Erik Siesby. *Kosova, part of the former Yugoslavia*. Source: Turkish Daily News, [http://www.witnesspioneer.org/vil/Articles/politics/kosova\\_formes\\_yogoslavia.htm](http://www.witnesspioneer.org/vil/Articles/politics/kosova_formes_yogoslavia.htm)

qëllimeve të tyre, por kjo njëanshmëri dhe këto aspirata hegjemoniste do të mbesin njollë e pashlyer përjetësisht në historinë evropiane.

Nëse e kemi kuptuar këtë të vërtetë, atëherë bëjmë mirë të thellohemi edhe pak, në mënyrë që të arrijmë tek zanafilla e problemit dhe të zbulojmë se cilat ishin shkaqet që çuan në rënien e kësaj perandoria gjigante dhe cili ishte qëndrimi i shqiptarëve muslimanë karshi kësaj sfide (sprove) të madhe. Për këtë, fjalën do t'ia japim historianit të famshëm, Dr. Imaduddin Halil<sup>28</sup>, i cili thotë: *'Degradimi nuk është një proces që nënkupton domosdoshmërisht rënien përfundimtare apo tërheqjen nga mejdani. Degradimi nuk ndodh rastësisht apo në periudha të shkurtra kohore. Përkundrazi, elementet e tij grumbullohen nga anë dhe aspekte të ndryshme në periudha të gjata, që zakonisht zgjasin me shekuj. Po kështu, degradimi nuk është pjellë e një shkakut, por e një grupi shkaqesh që janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe rrjedhimisht është vështirë që t'i ndash ato për të përcaktuar rrezikun e secilës veç e veç. Dukuria e degradimi formësohet dalëngadalë dhe për një kohë të gjatë, dhe në këtë proces ndikojnë shkaqe me natyrë nga më të ndryshmet, si: të besimit, politikës, administratës, ekonomisë, shoqërisë, gjeografisë, vlerave kulturore-morale etj.'*

Ndërsa ne, gjatë hulumtimit tonë për shkaqet e çështjes në fjalë, kemi arritur në pikat në vijim:

- 1) Ngecja shkencore dhe teknologjike e Perandorisë<sup>29</sup>,
- 2) Fanatizmi kombëtar dhe nacional, i cili filloi të shfaqet në mjedise të krishtera në shtetin osman, të cilët e shihnin veten superiorë ndaj muslimanëve. Në fakt, nacionalizmi filloi me kryengritjen greke në vitin 1821.
- 3) Pansllavizmi ruso-ortodoks, i cili luajti një rol të rrezikshëm në rrëzimin e Perandorisë Osmane, me qëllim të kinse çlirimit të të krishterëve nga osmanët<sup>30</sup>.

---

<sup>28</sup> Shih: *Haule avamili ted'huri-l-hadareti-l-islamijeh*, revista: Texhdid, f. 9-49.

<sup>29</sup> McCarthy, Justin. *Death and exile*, f. 5-6; Poullton, Hough. *Muslim identity and the Balkan state*, 15.

<sup>30</sup> Ibid.

- 4) Zhveshja nga morali dhe jeta fetare, si dhe zhytja në korrupsion dhe gjëra të tjera të ndaluara fetarisht<sup>31</sup>.
- 5) Humbja e kontrollimit të plotë mbi sigurinë e popujve të perandorisë, për shkak të çlirimeve dhe luftërave të njëpasnjëshme. Perandoria që zgjeruar në të tri kontinentet e botës, ndërsa kostoja e mbikëqyrjes ishte tejet e madhe. Historia e Perandorisë, përgjatë pesë shekujve të sundimit, njeh vetëm 28 vite pa luftëra<sup>32</sup>. Pra, ajo ishte lodhur dhe dobësuar nga gjithë këto luftëra.
- 6) Përvetësimi i stilit perëndimor të jetesës, që nënkupton zhytjen në lukse dhe dëfrime, kostoja e të cilave i ngarkoi shtetin një sërë borxhesh të papërballueshme, të cilat, për pasojë, në kohën e Sulltan Abdul Mexhidit e çuan shtetin drejt falimentimit ekonomik.
- 7) Shkak i rënies së Perandorisë, jo i drejtpërdrejtë, por siç thuhet i fshehtë, ishte edhe papërgjegjësia e dijetarëve muslimanë, thirrësve dhe hoxhallarëve në detyrat e tyre, respektivisht në thirrjen e njerëzve në zbatimin e fesë së Allahut, në ruajtjen e urdhëresave dhe ndalesave të Tij, në këshillimin reciprok, në urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja<sup>33</sup>, e kështu me radhë.
- 8) Disa mendojnë se degradimi i Perandorisë ka filluar me vdekjen e Sulltan Sulejman Kanuniut, në vitin 1566.
- 9) Në periudhën e fundit, nacionalistët turq krijuan idenë e *turanizmit* dhe politikën e turqizmit, ide dhe projekt i ndyrë pas të cilit qëndronin çifutët ballkanas të maskuar me emra muslimanësh.

---

<sup>31</sup> Wire, John. *Albania the rise of a Kingdom*, f. 1; Biberaj, Elez. *Albania, a socialist Maverick*. F. 13; Maksudoglu, Mehmet. *Ottoman history based mainly on Ottoman sources*, 340-346.

<sup>32</sup> Feraj, Hysamedin. *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 68-77.

<sup>33</sup> Castellán, Georges. *Histori e Ballkanit*, shek: XIV-XX, 217-218; Alpan, P. Nexhip-Kaci, Nesim. *Shqiptarët në Perandorinë osmane*, f. 22-23.



Pasojat e kësaj ideje ishin të paparashikueshme, madje edhe sot e kësaj dite janë evidente<sup>34</sup>.

- 10) Futja e reformave administrative dhe ndërhyrjet në Kushtetutën e vendit (turq. *tanzimati*) nga ana e disa intelektualëve turq të shkolluar në vende perëndimore<sup>35</sup>, të cilat ishin shenjë paralajmëruese e dobësimit dhe, më pas, rënies së shtetit osman.

Një përmbledhje të shkaqeve të rënies së shtetit osman e ka bërë edhe Dr. Ali Muhammed Salabi, citimin e të cilave do të sjellim shkurtimisht në vijim:

- 1) Zbehja e miqësisë dhe armiqësisë në baza fetare (ar. *el-vela ve-l-bera*)
- 2) Tkurrja e botëkuptimit të adhurimit (ibadetit)
- 3) Përhapja e besëtytnive, shirkut dhe risive
- 4) Shfaqja e sofizmit të devijuar
- 5) Aktivizimi i fraksioneve të devijuara
- 6) Humbja e udhëheqjes sipas frymës fetare
- 7) Mohimi i hapjes së derës së ixhtihadit
- 8) Përhapja e padrejtësisë në vend
- 9) Luksi dhe zhytja në epshe
- 10) Kundërshtimi dhe ndarja në grupe e lëvizje.

Reformat, që përfshinin aspektin politik, fetar dhe shoqëror të perandorisë, edhe pse kishin për qëllim reformimin në nivelin e përgjithshëm të saj, i kushtoheshin veçanërisht muslimanëve dhe pas tyre qëndronin planet e

---

<sup>34</sup> Këtë mendim e mbron Prof. Dr. Muhammed Behauddin Husejn, profesor im Allahu e mëshiroftë, prof. i asociuar në Universitetin Ndërkombëtar Islam në Malajzi. Takimi është zhvilluar më datë 11.03.2003.

<sup>35</sup> Rizaj, Skender. *Lidhja shqiptare e Prizrenit*, f. 51; Castellan, Gerges. *Histori e Ballkanit*, f. 219; Maksudogllu, Mehmet. *Ottoman histori basen only on Ottoman sources*, f. 328-329.

fshehta çifute dhe të krishtera. Ndërsa sa i përket dëmeve të shkaktuara nga këto reforma, pra dëmeve për shqiptarët muslimanë, hulumtuesit kanë numëruar si më kryesoret:

- 1) Largimin e shqiptarëve nga pozitat udhëheqëse. Para reformave, shqiptarët kishin pozitat kryesore, ndërsa më pas ata u zëvendësuan me figura dhe personalitete të tjera, edhe nga të huajt (joturqit)<sup>36</sup>. Kjo gjë nuk kaloi pa provokim konfliktesh të shqiptarëve me këta përfaqësues të rinj të huaj që vinin në tokat shqiptare.
- 2) Ideja e reformimit e rëndoi tej mase gjendjen e shtresës së varfër, ngase deri atëherë shërbimi ushtarak paguhej dhe ishte i përkohshëm, ndërsa me reformim jo vetëm që u zgjat koha e shërbimit në 7-12 vite, por u hoq edhe pagesa që ishte më parë<sup>37</sup>.

---

<sup>36</sup> Feraj, Hysamedin. *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 68-77.

<sup>37</sup> Ibid.

## KAPITULLI II: KOMPLOTET POLITIKO-FETARE NGA ORTODOKSËT DHE KATOLIKËT PËR SHFAROSJEN E MUSLIMANËVE NË BALLKAN

---

### 1. LËVIZJA FETARE RUSO-SERBE DHE QËNDRIMI ZHGËNJYES EVROPIAN KARSHI ÇËSHTJES ISLAME NË BALLKAN SI BARRIERË TJETËR DIALOGU<sup>38</sup>

Sa i përket lëvizjes pansllaviste ruso-ortodokse, ajo kishte si objektiv shpëtimin e të krishterëve ortodoksë dhe çlirimin e tyre nga pushteti osman-islam dhe ai austro-katolik. Besonin se banorët e Rusisë, Polonisë, Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Bullgarisë dhe Çekosllovakisë ishin një komb, që kishin origjinë dhe prejardhje të njëjtë<sup>39</sup>.

Rusët, po kështu, e shihnin fundin e Evropës dhe, paralel me të, lindjen e një perandorie të re, qendër e së cilës do të ishte Stambolli, andaj edhe kur bënë luftën me osmanët në vitin 1853-1856, ata hynë me bindjen se ka ardhur koha e themelimit të një perandorie të madhe të pritur shumë kohë më parë<sup>40</sup>.

Burimet historike flasin se bashkimi i dy Gjermanive, asaj lindore dhe perëndimore në vitin 1871, kishte ringjallur ëndrrat dhe aspiratat fetare të rusëve për realizimin e kësaj perandorie. Këtë mund ta vërejmë qartë në librin 'Rusia dhe Evropa', të orientalistit të njohur rus, Nikolaj Jakovleviç Danilevskij, i cili ndër të tjera thotë: "*Problematika lindore në shekullin e XIX-të nuk është tjetër veçse një episod i luftës së gjatë ndërmjet Romës dhe Greqisë, duke nënkuptuar këtu me Greqinë të krishterët ortodoksë dhe me Romën ata*

---

<sup>38</sup> Për detaje rreth kësaj teme, shih një punim të Dr. Muhammed Abdunebij nga Universiteti i Algjerisë, me titull: *Mevaniu-l-hioar bejne akideti-d-d'afi ve ukdeti-l-kuvoeti ve-l-mizaxhi-l-munharifi*, f. 4-30.

<sup>39</sup> Rizaj, Skender. *Lidhja shqiptare e Prizrenit*, f. 40; Frashëri, Mehdi. *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe shqiptarëve*, f. 34-35.

<sup>40</sup> *Ibid*, f. 40.

*katolikë, dhe se gjermanët sot llogaritën si pjesëtarë (ithtarë) të Romës, ndërsa rusët si ithtarë të Bizantit, pra si ortodoksë.”<sup>41</sup>*

Nga fjalët e këtij orientalisti mësojmë edhe për urrejtjen e rusëve ndaj të tjerëve, në mënyrë të veçantë ndaj muslimanëve, si një gjë e lindur tek ata, që nuk do t’iu ndahet kurrë sa të ekzistojë kjo botë. Kjo për shkak se studimi i lindjes islame (orientalizmi) ka ardhur si rezultat i një vendimi kishtar dhe si pasojë e kryqëzatave. Edhe studimi i trashëgimisë islame nuk është bërë me motiv tjetër veçse atij të kolonizimit dhe pushtimit. Në fakt, këtu fillon edhe përvoja e parë kolonialiste, pasi që Evropa për herë të parë doli jashtë kufijve të saj dhe tentoi të gjente zgjidhje për problemet komplekse nga të cilat vuante, qofshin këto të natyrës fetare, shoqërore, ekonomike etj. Pas rrëmujave dhe çrregullimeve të shfaqura në kishë dhe në shoqëri, Papa Urbani II (1088-1099) mendoi për një aventurë të re, që do ta bashkonte rreth një qëllimi të caktuar botën e krishtere. Kësisoj, në një seancë të jashtëzakonshme në nëntor të vitit 1095, Papa mbajti një fjalim në Akademinë Kishtare, në atë që njihet si Këshilli i Klermontit, ku u shpreh deklarativisht: *“Çohuni dhe ato armë që ua drejtonit vëllezërve tuaj, drejtojuani armiqve tuaj, armiqve të krishterimit. Ju i bëni padrejtësi jetimëve dhe grave të veja, ju nuk e kurseni veten aspak nga vrasja dhe grabitja, ju plaçkitni njerëzit në rrugë publike, pa frikë dhe pa turp pranoni mito për të vrarë dhe derdhur gjakun e vëllezërve tuaj të krishterë. Ju jeni si shpendët grabitqarë që hanë kafshë të ngordhura, të cilat tërhiqen nga era kundërmuese e njerëzve. Ju jeni viktimat e lakmisë suaj. Çohuni pra dhe mos vrisni vëllezërit tuaj të krishterë, por ata që kanë pushtuar qytetin e shenjtë (Kudsin). Luftoni nën flamurin e krishterë. Le të jetë për ju vetëm një komandant. Sakrifikoni veten tuaj, ngase ju jeni që keni bërë mëkatet më të mëdha, ndërsa ky është vullneti i Zotit.”*

Papa Urbani II është pasardhës i Papës Gregori VII, me prejardhje çifute, i cili ishte ideatori i kryqëzatave për çlirimin e Kudsit<sup>42</sup>.

Pas këtyre ngjarjeve, Serbia dhe Mali i Zi, në vitin 1876, do të paralajmëronin kryengritje kundër shtetit osman. Në fakt, ajo që i motivoi

---

<sup>41</sup> Ibid, f. 51.

<sup>42</sup> Abdul Fettah, Fatime. *Idaat alel istishraki-rr-rrusijj*, f. 18.

ata ishte lëvizja sllave ortodokse ruse, e cila nga dita në ditë sa vinte e shfaqej më e madhe dhe më e rrezikshme, derisa edhe çështja u ngrit në nivelin e: 'O Islami, o Krishterimi', 'O muslimanët, o të krishterët', 'O Evropa, o Azia.'

Në këtë kohë, kundër shtetit osman paralajmëron luftë edhe Anglia, duke e komplikuar tej mase çështjen për shtetin osman, si dhe duke e kompletuar, nëse mund të thuhet kështu, edhe hallkën e fundit të Evropës për luftë kundër muslimanëve.

Kjo urrejtje u shfaq edhe karshi muslimanëve shqiptarë, ku në Kongresin e Berlinit, më 1877, u punua në mënyrë të qëllimshme për ta nxjerrë nga rendi i ditës çështjen e tyre. Ata përpiluan edhe një dokument me kërkesat e tyre ndaj shtetit osman, në të cilat vërehet gabimi i madh, e mbase edhe i qëllimshëm, në raport me muslimanët shqiptarë. Le të përmendim disa nga pikat e këtij dokumenti për ta kuptuar këtë të vërtetë:

- 1) Çarmatimi i rezistencës muslimane bullgare dhe boshnjake
- 2) Tërheqja e nëpunësve muslimanë nga këto rajone
- 3) Formimi i policisë vetëm nga të krishterët
- 4) Qëndrimi i ushtrisë osmane vetëm në kala të fortifikuara
- 5) Heqja e xhizjes që ia paguanin shtetit osman
- 6) Përdorimi i gjuhës sllave në gjykata dhe ambiente qeveritare
- 7) Caktimin e valinjve të krishterë në vendet islame, siç ishte rasti me valiun e Libanit
- 8) Ndëshkimi i muslimanëve pjesëmarrës në krime kundër të krishterëve dhe detyrimi i tyre për t'i kompensuar materialisht ato dëme...

Siç mund të vërejmë, në këtë dokument shqiptarët nuk janë përmendur fare, ndërsa çështja e tyre është harruar tërësisht nga diplomatët perëndimorë<sup>43</sup>.

Fatbardhësisht, Kongresi dështoi, ndërsa pjesëmarrësit nuk u pajtuan rreth pikave të këtij dokumenti, kurse turqit e refuzuan atë në tërësi. Përballë kësaj gjendjeje, Rusia nuk gjeti rrugë tjetër veçse të shpallte luftë kundër shtetit osman në vitin 1878, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi, duke përfituar nga rasti që shteti osman ishte i zënë me Rusinë, i shpallën dinakërisht luftë duke menduar se ai nuk do të ketë fuqinë e mbizotërimit mbi ta.

Shteti osman ishte dobësuar dhe druhej të futej në luftë kundër Ruisë pasi mund të pësonte humbje edhe më të mëdha, kështu që lidhi me të një marrëveshje prej njëzetënëntë pikash, që të gjitha apo shumica në dëm të interesit politik, gjeografik, kulturor dhe shoqëror të shqiptarëve.

Duke pasur parasysh këto zhvillime të hidhura, shqiptarëve nuk iu mbeti tjetër vetëm se, ndërmjet viteve 1878-1885, të themelonin një ligë, të cilën e quajtën 'Lidhja Shqiptare e Prizrenit', për të larguar rrezikun që i kanosej tokave të tyre. Kjo lëvizje ishte si të thuash një lloj rezistence gjithëpopullore kundër politikave të shtetit osman ndaj tyre, si dhe ndaj vendimeve të padrejta të shteteve evropiane.

Skënder Rizaj numëron këto shkaqe që çuan në themelimin e kësaj lidhjeje:

- 1) Reformat politike, shoqërore dhe administrative në shtetin osman, që ishin në dëm të shqiptarëve
- 2) Spastrimi në baza fetare dhe internimi i dhunshëm i shqiptarëve jashtë shtetit të tyre
- 3) Nevoja e madhe e pavarësimit, ashtu siç qenë pavarësuar Serbia dhe Mali i Zi.

---

<sup>43</sup> Çuditërisht, shqiptarët nuk i përmend as historiani turk, Mehmet Maksudoglu, kur flet për historinë e shtetit osman!

Ndërsa shkakun e daljes publike të kësaj lëvizjeje, Skënder Rizaj na e sjell nëpërmjet citimit që i bën një hulumtuesi turk: *'Si rezultat i luftës turko-ruse në vitin 1877 ishte edhe aspirata e vendeve të Ballkanit për zgjerim territorial në llogari të tokave shqiptare. Kjo gjë i shtyri shqiptarët të mendojnë për të ardhmen e tyre dhe fatin pas rënies së shtetit osman. A mund të paramendohej pranimi i pushtetit grek apo serb dhe kështu të ktheheshin në robëri prapë?! Për këtë shkak themeluan lëvizjen që të kenë një Këshill Kombëtar në Shqipëri, për t'u pavarësuar (ndarë) nga shteti osman.'*<sup>44</sup>

Së fundmi, në luftën ballkanike 1912-1913, kur e panë rrezikun që i kanosej edhe ekzistencës së tyre si identitet i veçantë kombëtar dhe fetar, ata (shqiptarët) u ngritën dhe shpallën pavarësinë e tyre nga shteti osman<sup>45</sup>.

Konsideroj se një politikë më ndryshe e Portës së Lartë karshi shqiptarëve, kuptohet në të mirë të tyre, do të kishte efekte të padiskutuara pozitive. Besnikëria dhe sinqeriteti i shqiptarëve ndaj Perandorisë është dëshmuar historikisht. Pothuajse nuk ka pasur luftë të madhe, ku pjesëmarrës, në cilësinë e komandantëve të lartë, të mos kenë qenë shqiptarët.

---

<sup>44</sup> Rizaj, Skënder. *Lidhja shqiptare e Prizrenit*, f. 115.

<sup>45</sup> Necip P Alpaslan – Nesim Kaci. *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, f. 15.

## 2. QËNDRIMI DËSHPËRUES I SHTETEVE EVROPIANE KARSHI SPASTRIMIT ETNIK TË MUSLIMANËVE SHQIPTARË DHE BOSHNJAKË NGA SERBËT

Në kohën bashkëkohore, tokat shqiptare kanë përjetuar zhvillime dhe ndryshime të mëdha, nga të cilat edhe spastrimin etnik dhe largimin e dhunshëm të banorëve autoktonë. Ata u detyruan në mënyrë të dhunshme të lëshonin vendet e tyre dhe të merrnin botën në sy, pa ditur fare se ku po shkonin. Ishte ky një plan famëkeq, i përpiluar nga rusët, serbët dhe bullgarët, dhe i përkrahur dhe monitoruar nga vendet evropiane përreth. Për fat të keq, ky qëllim apo kjo strategji, në pjesën më të madhe të saj, është realizuar. Një pjesë e madhe e shqiptarëve u larguan nga tokat e tyre, në të cilat më pas u vendosën hordhitë serbe, ruse, bullgare e malazeze.

Në Kongresin e Berlinit ndodhi e keqja më e madhe apo u bë tregti me tokat shqiptare. Serbisë iu dhanë shumë toka shqiptare, kurse organizatorët e Kongresit nuk e panë të nevojshme pjesëmarrjen e një delegacioni nga Kosova në punimet e Kongresit, prandaj edhe nuk iu dhanë leje për të marrë pjesë. Kështu, ata i mohuan botërisht të drejtat e shqiptarëve, madje mohuan edhe identitetin e tyre shekullor, duke mos i thirrur si shqiptarë por si turq.

Motivet që i shtynë shqiptarët të largoheshin nga vendi i tyre ishin fetare, ekonomike dhe politike. Sigurisht se shkak kryesor mbetet shërbimi i detyruar ushtarak në ushtrinë serbe, e që, pos tjerash, nënkuptonte veshjen e veshjeve të tyre, si dhe ngrënien e ushqimeve të tyre, gjëra këto që ishin në kundërshtim me fenë e tyre<sup>46</sup>.

Historia ka regjistruar krimet makabre të kryera nga serbët ndaj muslimanëve shqiptarë. Ata ua dhunonin atyre gratë, ua plaçkitnin pasuritë, i bllokonin dhe fusnin në embargo, i digjnin për së gjalli në xhami, ua shkatërronin pasuritë e përgjithshme etj.

---

<sup>46</sup> Rizaj, Skënder. *Lidhja shqiptare e Prizrenit*, f. 79.



Shqiptarët u menduan mirë për pasojat që do të kishte rënia eventuale nën zgjedhën serbe, jo vetëm në aspektin fetar por dhe në atë kombëtar, andaj edhe vendosën të emigronin<sup>47</sup>. Shkak tjetër ishte edhe përvoja e hidhur e muslimanëve bullgarë, të cilët, për t'i shpëtuar masakrave dhe krimeve, pranuan të konvertoheshin në të krishterë ortodoksë, gjë kjo e papranuar për shqiptarët, andaj edhe morën rrugën e kurbetit, si zgjidhje me pasoja më të vogla<sup>48</sup>. Ata hoqën të zitë e ullirit nga presioni sllavo-krishterë, i cili tërë këtë presion dhe dhunë e ushtronte në emër të sllavizmit dhe krishterimit ortodoks<sup>49</sup>.

Ka hulumtues që shkaqet e migrimit ia faturojnë çështjes ekonomike, por kjo mund të thuhet vetëm për një pjesë, mbase të pavërejtur, dhe jo si shkak i përgjithshëm. Kjo teori thotë se shekulli i XIX-të përjetoi një lloj bumi industrial andaj edhe pati migrime masive. Vetëm në Stamboll migruan hiç më pak se 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) shqiptarë, ndërsa prej aty migronin më pas në Greqi, Rumani, Rusinë Jugore, Amerikë, Australi etj. Madje, ata që kanë migruar të shtyrë nga faktori ekonomik janë shqiptarët e konfesionit të krishterë ortodoksë<sup>50</sup>.

Ndikim të madh në këto veprime politike patën edhe orientalistët serbë. Vlerësohet se politikanët i bindeshin fjalëve të tyre dhe kishin bashkëpunim të madh në çështjen e spastrimit. Ishin orientalistët ata që përgatitën rrugën e spastrimit dhe ne mund ta vërejmë këtë gjë shumë qartë në idetë e tyre të shprehura në letër. Ata mbronin idenë se Serbisë mund t'i garantohet qetësia vetëm atëherë kur ta ketë pastruar shtetin nga çdo element josllav, ndërsa, për habinë e të gjithëve, migrimet e

---

<sup>47</sup> McCarthy, Justin. *Death and exile*, f. 138-141.

<sup>48</sup> Ibid, f. 152-153.

<sup>49</sup> Për më shumë shih: Cana, Zekeria. *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullatën shqiptare 1912-1913*, f. 11; Ajdini, Azem. *Masakra e Tivarit Serbo-Malazeze*; Kansu, Huseyin. *Kosova ikinci Bosna olmasin*, f. 11-33; Bajrami, Hakif. *Kosova – njëzet shekuj të identitetit të saj – argumente historike*, f. 77-81; Kola, Harrila. *Gjenocidi serb ndaj shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi 1941-1967*, f. 116-222.

<sup>50</sup> Për më shumë shih: Thengjilli, Petrika. *Historia e Shqipërisë*, f. 27; Mufaku, Muhamed. *Shqiptarët në botën arabe*, f. 97-130; Silajxhiç, Haris. *Shqipëria dhe SHBA-të në arkivat e Washingtonit*, f. 25-42.

shqiptarëve i shihnin si çështje private të tyre dhe jo se ata i ishin nënshtruar ndonjë presioni apo imponimi prej tyre<sup>51</sup>.

Historia na flet se migrimet masive të shqiptarëve bëheshin për shkak të marrëveshjeve sekrete turko-jugosllave, ndërmjet viteve 1939-1944, kur në Turqi nuk kishte më asnjë element të sundimit islam. Kjo marrëveshje nënkuptonte që tokat e shqiptarëve të banoheshin më pas nga serbët e ardhur. Llogariten diku rreth 8.000 familje shqiptare të deportuara me dhunë, familje këto nga qytete të cilat asokohe ishin pjesë e Kosovës ndërsa sot janë pjesë e Serbisë, si: Leskovci, Prokuplja, Vranja, Kurshumlia dhe Piroti<sup>52</sup>. Procesi i migrimit ishte tejet barbar. Shqiptarëve iu digjeshin shtëpitë, iu granatoheshin fshatrat, iu konfiskoheshin pasuritë etj. Vetëm në fillim të shek. të XX-të, janë djegur tërësisht 182 fshatra me banorë shqiptarë muslimanë<sup>53</sup>.

Rusët patën armatosur bullgarët ortodoksë<sup>54</sup> dhe i patën nxitura ata për luftë kundër muslimanëve vendas, ndërsa qeveria malazeze i kërcënonte muslimanët lokalë se, po nuk u armatosën për luftë kundër muslimanëve, do t'i dëbonte jashtë shtetit<sup>55</sup>. Sipas statistikave, ndërmjet viteve 1877-1879, nga Ballkani janë larguar në mënyrë të dhunshme jo më pak një milion muslimanë shqiptarë<sup>56</sup>, prej të cilëve 200.000 ishin nga Kosova.

Tjetër çështje që të çudit, por për të keq, është edhe ajo e udhëtimit, respektivisht mjeteve transportuese. Janë për të të habitur veprimet e shtetit osman, gjithsesi të këtij që po merrte frymëmarrjet e fundit, që për këtë migrim të dhunshëm të shqiptarëve pati huazuar me pagesë anije

---

<sup>51</sup> Rizaj, Skënder. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*; Zamir, Shtylla. *The deportation of Albanians in Yugoslavia after The Second World War 1950-1966*, f. 233-239; Cubrilovic, Vaso. *The problem of minorities in the new Yugoslavia*, f. 301-306.

<sup>52</sup> Pllana, Emin. *On the deportation of albanians from the territory of Sandjak of Nish of Kosova 1877-1878*, f. 73-78.

<sup>53</sup> Bajram, Hakif. *Kosova - njëzet shekuj të identiteti të saj*, f. 84.

<sup>54</sup> Skënder Rizaj mbron mendimin se, ashtu siç ka rrëfyer edhe ambasadori anglez në Stamboll, qëllimi i rusëve me këto veprime ishte pushtimi i Ballkanit dhe përvetësimi i pasurive dhe pronave të muslimanëve. Shih: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 81.

<sup>55</sup> Rizaj, Skënder, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 79; McCarthy, Justin. *Death and exile*, f. 88-91.

<sup>56</sup> Rizaj, Skënder, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 80.

transportuese nga Anglia, Franca, Austria, Egjipti, Rusia, ndërsa destinacioni i “refugjatëve” ishte për në Izmir, Samsun, Çanakkale, Stamboll dhe Edirne<sup>57</sup>. Në fakt, këto nuk ishin qytetet e vetme ku vendoseshin ata, pasi kishte prej tyre që mësynin Anadollin, Sirinë, Damaskun, Ujdhesën Arabe, Selanikun etj.

Konsideroj se, në këtë rast, ia vlen të përmendim vlerësimet e një lideri ekstremist serb, i njohur si bajraktar i deportimit të dhunshëm të muslimanëve, Vasha Çubrilloviçit, i cili thotë: *‘Procedura e deportimit të turqve (shqiptarëve, boshnjakëve, turqve dhe çerkezëve) dhe banimi i tyre me serbë dhe malazezë<sup>58</sup> është realizuar me ritëm më të mirë se që kemi pritur dhe kemi planifikuar... Serbët e persekutuar nga shqiptarët<sup>59</sup>, dhe të cilët patën ikur nga*

<sup>57</sup> Rizaj, Skënder, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 80; Poullton, Hough, *Muslim identity and the Balkan State*, f. 146-148.

<sup>58</sup> Statistikat e viteve 1905-1906 tregojnë se prania e muslimanëve ishte shumë e theksuar në trojet shqiptare, por ata më pas qenë detyruar të largohen nga shtëpitë dhe vendet e tyre.

Nr.	Vendi	Muslimanë	Të tjerë
1.	Prishtinë	254,605 (shqiptarë)	110,310 (shqiptarë katolikë dhe ortodoksë, serbë, bullgarë, romë.)
2.	Pejë	139,901 (shqiptarë)	45,784 (shqiptarë katolikë dhe ortodoksë, serbë)
3.	Novi Pazar	27,980 (shqiptarë dhe turq)	19,795 (shqiptarë të krishterë dhe serbë)
4.	Shkup	90,840 (shqiptarë)	60,706 (shqiptarë katolikë dhe serbë)
5.	Prizren (duke përfshirë këtu edhe Tetovën dhe Gostivarin)	158,742 (shqiptarë)	15,323 (shqiptarë katolikë dhe ortodoksë); 11,606 (serbë); 473 (romë).
6.	Manastir	457,994 (shqiptarë dhe turq)	264,008 (shqiptarë ortodoksë dhe vllëh); 198,335 (bullgarë); 55,108 (grekë); 2,760 (romë) dhe 354 (shqiptarë katolikë dhe protestantë).
7.	Vilajeti i Janinës	227,484 (shqiptarë)	213,281 (shqiptarë ortodoksë dhe vllëh); 91, 991 (grekë) dhe 4,906 (çifutë).

Burimi: <http://www.ess.uwe.ac.uk/kosovo/chap1.htm>

<sup>59</sup> Skënder Rizaj e demanton këtë thënie të Çubrilloviçit duke thënë se nuk ka asnjë dëshmi se shqiptarët i kanë dëmtuar serbët. Të gjitha ato janë farsa, gënjeshtër dhe shpifje që vetëm serbët mund t’i sajojnë. Shih: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 97-98.

*zona të thella malore, zbritën në këto fshatra dhe qytete. Vendbanimet shqiptare u ndërruan me ato serbe, edhe pse këto të fundit nuk kishin ekzistuar më parë...'*

Pasojat politike dhe shoqërore të detyrimit të shqiptarëve për t'u larguar nga vendet e tyre do të krijonin një hendek dialogu dhe bashkëjetese ndërmjet tyre dhe serbëve, i cili vazhdon së ekzistuari edhe sot, e mbase do të vazhdojë edhe për kohë të gjata<sup>60</sup>.

---

<sup>60</sup> Rizaj, Skënder, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 93.

### 3. QËNDRIMI I NJËANSHËM I AKADEMISË, POLITIKËS DHE FESË NË SERBI, SI NJË BARRIERË E DIALOGUT DHE BASHKËJETESËS NË PAQE

Përkitazi me idenë e 'Serbisë së madhe' dhe zhveshjen e saj nga elementet joslave, historiani kosovar, Dr. Musa Gashi, mendon se që nga fillimi i shek. të XX-të, akademikët serbë e kanë ushqyer popullin e tyre me helme përrallash, trillimesh, gënjeshtresh, premtimesh iluzionare për themelimin e një Serbie të tillë, të pamposhtur, me forcë dhe ndikim në Ballkan. Kohën e përshtatshme për realizimin e këtij makthi - nëse mund ta quajmë kështu ëndrrën e tyre të egër - e shihnin pas rënies së Perandorisë Osmane, atëherë kur edhe do të themelonin apo ringjallnin Mbretërinë e Serbisë së madhe, për t'u hakmarrë më pas ndaj muslimanëve shqiptarë si dhe për të marrë në dorë timonin e Ballkanit.

Ideatorë dhe ithtarë të kësaj ideje farësosur, që nga atëherë e deri më sot, ka pasur shumë, ndërsa si emra më të njohur do të veçonim: Ilija Garashani, Johan Cvijiç, Jovanoviçi, Radovanoviçi, Gjorgjeviçi, Duciçi, Moleviçi, Drazho Mihajloviçi, Vasa Çubrilloviçi, Slobodan Millosheviçi, Vojislav Shesheli, Vuk Karaxhiçi, Stefan Moljeviç, Millorad Ekmeciç, Vasiljo Krestiç, Mihajl Markoviç, Ivo Andriçiç, Dobrica Casiç, Petar Gračanin, Ratko Mlladiç, Radovan Karaxhiç etj.

Këta ishin personat që qëndronin prapa besëtytnive se kinse Serbia ka qenë viktimë e betejës së famshme të Kosovës në vitin 1389, të cilën edhe pse e humbën, ata konsiderojnë se e kanë fituar. Bazuar në këtë besëtytni (përrallë), serbët janë popull i viktimizuar, janë popull i Zotit, gjaku i tyre është i shenjtë, po kështu edhe historia, tokat dhe kufijtë janë të shenjtja, ngase këto janë dhe mësimet e Kishës Ortodokse, së cilës i faturohen ndezjet e luftërave në Ballkan dhe më gjerë, madje vetë serbët e pranojnë se janë shkaktarët kryesorë të ndezjes së Luftës së Parë dhe të Dytë

Botërore. Për shkak të këtyre politikave neveritëse, Evropa u përmyt në luftëra dhe krime të rënda<sup>61</sup>.

Këto janë dëshmitë e njerëzve kompetentë për rolin negativ që ka luajtur akademia shkencore, politike dhe fetare serbe, në bashkëjetesën ndërmjet popujve ballkanas. Dialogu, për fatin tonë të keq, vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë peng i personaliteteve me mentalitet, e madje edhe aspirata të tilla.

Prej dokumenteve sekrete serbe, që shpalosin qartë idetë dhe aspiratat e tyre, është edhe ai i publikuar në vitin 1906, në të cilin nënvizohet projekti famëkeq i Ilija Garashanit, njërit prej personaliteteve dhe liderëve serbë, i njohur për fanatizmin dhe urrejtjen e tij ndaj joslavëve, për rikthimin e mbretërisë së Car Dushanit, të shkatërruar dhe të zhdukur nga Perandoria Osmane. Në thelb të projektit, të njohur si '*Nacertanija*', qëndronte ideja e pansllavizmit serb, e cila thërriste që serbët të punonin për të bashkuar të krishterët ortodoksë, të cilët ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane, t'i zgjeronin kufijtë në llogari të tokave shqiptare si dhe të punonin në drejtim të shumimit të serbëve, të cilët asokohe ishin 1. 400.000. Për realizimin e këtij plani, historianët veçojnë vitet 1870-1880 si vitet në të cilat ata bënë shtrembërimin dhe falsifikimin e planprogrameve shkollore dhe trojeve shqiptare në Kosovë i thanë: Stara Serbija-Old Serbia duke u bazuar në burime të falsifikuara, legjenda dhe mite. Poashtu edhe qendrat institucionale në Beograd, orientalistët kanë kontribuar negativisht në renjosjen e kësaj ideologjie të gabuar dhe arsytimin e etnocidit dhe kulturocidit ndaj muslimanëve në kokat e gjeneratës serbe në shkollat fillore, atyre postdiplomike në nivelin master dhe doktoraturë, po edhe tani herën e fundit në luftën e Bsonjes (1990-1995) dhe në luftën e Kosovës(1997-1999).

Rol të keq dhe tejet negativ kanë luajtur edhe orientalistët, të cilët kanë bërë përpjekjet më të mëdha për t'i paraqitur muslimanët si qenie johumane, si të tepërt në Ballkan dhe në Evropë, andaj edhe kanë kërkuar

---

<sup>61</sup> Gashi, Musa, *Some facts about Kosova*, f. 67-69; Bajrami, Hakif, *Politika dhe lufta e drejtë shqiptare përballë neofashizmit serb*, f. 185-250.

një farë arsytimi për t'i shfarosur muslimanët dhe për të shlyer çdo gjurmë të tyre. Darko Tanaskoviç, në librin e tij 'Islami dhe ne', orvatet ta justifikojë shfarosjen kolektive të muslimanëve dhe shpreh habinë se si nuk e kanë edhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar për këtë nismë. Sipas tyre Evropa nuk ishte në gjendje ta kuptojë se serbët ishin shpetues të saj prej Islamit, dhe mu për këtë arsye ata i shfarosnin muslimanet! Ai e shihte shfarosjen e muslimanëve si një punë me të cilën ruhej edhe Evropa, andaj thoshte bindshëm se serbët janë kundër Islamit dhe se, patjetër, duhet të jenë kundër!

Orientalist tjetër me ndikim është edhe Mirosljub Jevtiç, i cili vazhdon të shkruajë shkrime plot helm kundër Islamit, të cilin ai e sheh si pengesë të bashkëjetesës. Shkrimet e tij janë të atilla që, për nga ironia dhe blasfemia e tyre, të detyrojnë të qeshësh me zor. Fajin pse muslimanët janë të egër dhe të vrazhdë – gjithnjë sipas tij – e ka therja e kurbanëve gjatë festave, me theks të veçantë festa e Kurban Bajramit, e cila kinse i mëson për të derdhur gjak që nga fëmijëria.

Rolin negativ dhe konfliktuoz të orientalistëve serbë e vërteton dhe orientalisti amerikan Norman Cigar<sup>62</sup>, i cili i akuzon ata për ndezjen e konflikteve, për përhapjen e urrejtjes ndërmjet bashkëkombësve, për akuza dhe shpifje nga më të ndryshmet në adresë të Islamit dhe muslimanëve, si: 'muslimanët janë të izoluar', 'Islami është i prapambetur, jo etik' e marrëzi të tjera që vetëm serbët mund t'i trillojnë.

---

<sup>62</sup> Shih: Cigar, Norman. *The role of Serbian Orientalists in Justification of genocide against muslims of the Balkans*, f. 5-57.

## PËRFUNDIM

---

Në përfundim të këtij referimi të përgatitur enkas për këtë seminar ndërkombëtar, konsideroj se audienca (lexuesi) e kanë të qartë vështirësinë dhe natyrën politike, historike dhe kritike të temës, të cilën studiuesi është munduar ta trajtojë dhe paraqesë nga këndvështrimi bashkëkohor kritik, historik dhe përshkrues, për të rezultuar në pengesat kryesore që kanë pamundësuar bashkëjetesën në paqe të popujve muslimanë dhe të krishterë të Ballkanit. Këto pengesa janë vërejtur në qëndrimet dëshpëruese dhe të turpshme si nga shtetet evropiane karshi muslimanëve ballkanas, si nga serbët, rusët dhe bullgarët ndaj bashkëqytetarëve muslimanë.

Islami ynë na urdhëron që historinë ta lexojmë me qëllim që të marrim këshilla dhe mësim, e jo sa për hobi apo humbje kohe. Unë jam i bindur se kriza e muslimanëve ballkanas nuk do të zgjidhet kurrë dhe rrjedhimisht bashkëjetesa paqësore nuk do të arrihet askund në botë, nëse qëndrimet dëshpëruese të të krishterëve të vjetër ndaj muslimanëve trashëgohen edhe nga gjeneratat e reja, duke mos përjashtuar këtu (krahas anglezëve, gjermanëve, austriakëve, rusëve) as amerikanët. Patjetër se duhet një objektivizëm, seriozitet, zhveshje nga urrejtja... Gjithkujt duhet t'i njihet e drejta, pa marrë parasysh fenë, racën apo kombin e tij. Thënë me qartë, gjithsesi ndërmjet dy palëve të armiqësuar duhet që të ekzistojnë botëkuptimet e drejtësisë dhe barazisë.

Dhe krejt për fund, përshëndetjet ia dërgojmë Muhammedit, alejhi's selam ndërsa lutjen e fundit e kemi falënderim për Allahun, Zotin e botëve!

*Medine Munevvere*

12/03/2007



## Bibliografia

### a. në arabisht

- (1993) *El-Islam fi Juguslafija min Belgrad ila Sarajefu*, Daru'l beshir, Amman.
  - (1996) *Es-Sultan Abdu'l Hamid eth-Thani - ahiru Selatin el-uthmanijjine'l kibar 1842 - 1918*, Daru'l kalem, Damask.
  - (1999) *El-Uthmanijjune fi't tarimi ve'l hadareh*, ed.2, Daru'l kalem, Damask.
  - (2000) *Mudahalat arabijjeh - balkanijjeh fi-t-tarihi-l-vesit ve-l-hadith*, Ittihad el-kitab el-arab, ed.1, Damask.
1. Arnaut, Muhammed Mufak,
  2. Muveffak Beni Merxheh, (1999) *Sahvetu'rr rrexhul el merid ev es-Sultan Abdu'l Hamid eth-Thani ve'l Hilafetu'l islamijjeh*, Muessesetu'rr rrejjan - Daru'l bejraik, ed.9, Bejrut.
  3. Harb, Muhammed,
  4. Abdu'l Fettah, Fatimeh, (2000) *Idaat alel istishrak err-rrusijj*, Ittihadu'l kitabi'l arab, ed.1, Damask.
  5. Avdeh, Selman, *Edebu'l hivar*, [www.islamtoday.net](http://www.islamtoday.net)
  6. Beg Halim, Ibrahim, *Tarihu'd Devleti'l uthmanijjeti'l ulja* (i njohur si *Et tuh fetu'l halimijjeh fi tarihi'd develti'l alijjeh*), ed.1, Muessesetu'l kutub eth-thekafijjeh, Bejrut, Liban.
  7. El-Emir Hasen Ibn Talal, *Hivaru'l hadarat...nedharat ve hatarat*, [www.islamonline.net](http://www.islamonline.net)
  8. Esvar, Halid, *El-Busneh hakaik ve erkam*, libër mujor i botuar nga Rabitatu'l Alemi'l Islamijj, v. 166.

9. Halife, Abdu'l Baki, *el-Istishrak es serbijj – et-te'silu li merekzijjetin urbijjetin mutealijetin ve udvanijjetin, kiraetun fi kutub el-musteshrikine es serb ve nedhretuhum lith thekafeti'l arabijjeti ve'l islamijjeh*, [www.asharqalawsat.com](http://www.asharqalawsat.com)
10. Halil, Imaduddin, (2000) *Hivaru avamili ted'huri'l hadareti'l islamijjeti*, revista Texhdid, e botuar nga Universiteti Ndërkombëtar Islam në Malajzi, v. 8.
11. Hejti, Abdu's Settar Ibrahim, *El Hivar...edh-dhat ve'l ahar*, libër i botuar nga Qendra për Hulumtime dhe Studime pranë Ministrisë së Fesë në Katar.
12. Ikihard, Sholts, *Hivaru'l hadarat...musalahatun em mesalih*, [www.islamonline.net](http://www.islamonline.net)
13. Ismajic, Abdullah, (1992) *Es-Sirau fi Juguslafija ve mustakbelu'l muslimine*, përktheu në arabisht: Saib Alavi, Mahed ed dirasat es-sijasijjeh, Islamabad, ed.1.
14. Muhammed, Abdu'n Nebijj, *Mevaniu'l hivar bejne akideti'd da'fi ve ukdety'l kuvety, sunnetu'l hivari ve'l mezaxhu'l munharif*, Xhamiatu El – Xhezaj.
15. Ogllu, Uthman, (1991) *Mudhekkiratu'l Emireti Aisheh, validej es; Sultan Abdu'l Hamid eth-Thani*, përktheu në arabisht: Salih Sa'davi Salih, Daru'l beshir, ed.1.
16. Saban, Suhejl, (2000) *El-Mu'xhem el-mevsuij lil mustalahat el-uthmanijjeh et-tarihijjeh*, Rijad, Mektebetu Melik Fehd el Vatanijjeh, ed.1.
17. Salabi, Ali Muhammed, (2001) *Ed-Devletu'l uthmanijjeh – avamilu'n nuhud ve esbabu's sukut*, Daru't tevezii ve'n enshri'l islamijjeh, Kajro.
18. Vasfi, Safvet, *Me'satu muslimi Kusufa ve vaxhibuna nahvoehum*, revista *el bejan*, reviste islame mujore, v.138, qershor 1999.

19. Xhundi, Enver, (1407) *Tas'hihu ekberi hatain fi't tarihi'l islamijj – es-Sultan Abdu'l Hamid eth-Thani ve'l hilafetu'l islamijjeh*, Kajro, Daru'l kutubi's selefijjeh, ed.1.

**b. në anglisht**

- 1994. *Bosnia – a short history*. New York, University Press.
  - 1998. *Kosovo – a short history*. New York, University Press.
2. *A building bridges between Islam and the test*, The Wilton Park Seminar, Wilton Park, West Sussex, December, 13, 1996. [www.bbcworld.com](http://www.bbcworld.com)
  3. As-Sibaa'ie, Mustafa, 2004, *The life of prophet Muhammad – Highlights and lessons*, International Islamic Publishing House, 1<sup>st</sup>
  4. Bajrami, Hakif, 1988, *Ilija Garasanin and his state policy between 1844-1874*, Annual, XIV, AK, Pristina.
  5. Biberaj, Elez. 1990. *Albania a socialist Maverick*. USA (n.p.h.)
  6. *Building bridges between Christianity and their religions*, [www.intervarsity.org/ism/article/105](http://www.intervarsity.org/ism/article/105)
  7. Cigar, Norman. 2003. *The role of Serbian orientalist in justification of genocide against Muslims of the Balkans*. Logos-A, Shkup.
  8. Cubrilovic, Vaso, *The problem of minorities in the new Yugoslavia, the truth of Kosovo*.
  9. Erik, Siesby, *Kosovo part of former Yugoslavia*, [www.witnesspieneer.org/vil/Articles/politics/kosova](http://www.witnesspieneer.org/vil/Articles/politics/kosova)
  10. *Expulsion of Albanians and Colonization of Kosovo*, [www.ess.uwe.ac.uk](http://www.ess.uwe.ac.uk)
  11. Gashi, Musa, 1997. *Some facts about Kosovo*, Logos-A, Shkup.
  12. George, Thomas, *Building a bridge between faiths in highly muslim nation*, [www.cbn.com/CBNNews/050510](http://www.cbn.com/CBNNews/050510)

13. Journal of Islamic Studies, vol.5, no.2, July 1994, Oxford University Press: Islam in the Balkans.
14. Justin McCarthy, 1999. *Death and Exile – The ethnic cleansing of ottoman muslims 1821-1922*, 3 ed. USA.
15. Karçiç, Fikret, *The Bosniaks and the challenges of modernity, late Ottoman and Hapsburg times*
16. Maksudoglu, Mehmet, 1993. *Ottoman history based mainly on ottoman sources*, Malaysia: International Islamic University.
17. Malcolm, Noel.
18. Norris, H.T. 1993. *Islam in the Balkans – Religion and Society between Europe and the Arab World*. London. Hurst & Company.
19. Plana, Emin, *On the deportation of Albanians from the territory of Sandjak of Nish of Kosovo 1877-1878 The truth of Kosovo*.
20. Poullton, Hough & Farouki, Suha Taji. 1997. *Muslim identity and the Balkan state*. London. Hurst & Company.
21. Swire, John. 1971. *Albania – the rise of a Kingdom*. Arno Press. New York: The New York Times.
22. *The truth of Kosovo*. 1993. The Academy of Sciences of the Republic of Albania. Institute of History. Tirana. Encyclopedia publishing Mouse.
23. Verli, Marenglen, 1999. *Kosovo -20/21, Prishtinë*.
24. Zamir, Shtylla, *The deportation of Albanians in Yugoslavia after the second world war 1950-1966*

### **c. në shqip**

1. Ajdini, Azem, *Masakra e Tivarit Serbo Malazeze*, Edlor, Tiranë, 1998.
2. Bajrami, Hakif, 2005,

3. Cana, Zekeria, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullatën shqiptare 1912-1913, Dokumente*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1996.
4. Castellan, Georges. 1991. *Historia e Ballkanit, shek. XIV-XX*, Tiranë, Çabej – Libra për një shoqëri të hapur.
5. Feraj, Hysamedin. 1997. *Skicë e mendimit politik shqiptar*. Shkup: Logos-A.
6. Frasheri, Mehdi. 2000. ed.2, *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe shqiptarëve*, Tiranë, Phoenix.
7. *Gjenocidi serb në Kosovë*, 1999. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Sesion shkencor, Tiranë.
  - *Historia e përgjithshme, Koha e re 1453-1789*, Prishtinë, UP, b.2, 1983.
8. *Historia e popullit shqiptar*, 1967, ed.3, Universiteti Shtetëror i Tiranës. Tiranë: Instituti i Gjuhës dhe i Historisë.
9. *Historia e Shqipërisë*. 1984. *Akademia e RPS të Shqipërisë*, Tiranë, Instituti i Gjuhësisë.
10. Kola, Harrila, *Gjenocidi serb ndaj shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi 1941-1967*, Elton, Tiranë, 2000.
  - *Kosova - njëzet shekuj të identitetit të saj - argumente historike*, ERA, Prishtinë, 2001.
  - *Kosova gjatë shekujve XV-XVI-XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë, 1982, Rilindja.
  - *Lidhja shqiptare e Prizrenit*,
11. Mufaku, Muhammed, 1990. *Shqiptarët në botën arabe*. Prishtinë: Rilindja.
12. P. Alpan & Kaci, Nesim. 1997. *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, Tiranë: Albin.

- Peticioni që i shpëtoi shqiptarët në Shqipërinë Kontinentale nga fashizmi serb, Dokumenti 1930, Gjon Bizaku, Shtjefën Kurti, Luigj Gashi, Prishtinë.
- 13. Pirraku, Muhammed. 1989. *Kultura kombëtare shqiptare deri në lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- 14. Rexhepagiq, Jashar. 1999. *Dervishët, rendet dhe teqetë në Kosovë, në Sanxhak dhe në rajonet përreth*. Pejë: Dukagjini.
- 15. Rizaj, Skënder,
- 16. Skendi, Stavro. 1967. *Zgjimi kombëtar shqiptar*. Tiranë: Phoenix.
- 17. Shehu, Bedrush, 1990. *Çështje shqiptare në vitet 30 të shek. XIX*, Prishtinë: Instituti albanologjik.
- 18. Thëngjilli, Petrika. 2001. *Historia e Shqipërisë*. Prishtinë.